



**SHOQERIA "LIRENG AUDITING" SH.P.K**

Adrese: Fringa, Duhret, Tull 424, Elbasan

Email: lireng.auditing@gmail.com

Tel/Fax: +355 42 450 952

Mob: 067 079155

**RAPORT I AUDITUESIT TE PAVARUR  
PER AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE  
TE AKTIVITETIT TE KOMITETIT OLIMPIK KOMBETAR SHQIPTAR  
PER PERIUDHEN 01.01.2011-31.12.2011**

**KOMITETIT OLIMPIK KOMBETAR SHQIPTAR**

**TIRANE**

**TE NDERUAR ZOTERINJ!**

Ne ekzekutimin e misionit qe na eshte besuar, kemi audituar Pasqyrat Financiare te "Komitetit Olimpik Kombetar Shqiptar", te cilat perfshijne pasqyrimin financiar per periudhen 1 Janar - 31 Dhjetor 2011 te sintetizuar ne Bilancin Kontabel te dates 31 Dhjetor 2011, pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyren e flukseve te parase, pasqyren e ndryshimeve ne kapital si dhe nje permbledhje te metodave kontabel me te rendesishme dhe shenime te tjera anekse qe shoqerojne keto pasqyra.

Drejtimi i entitetit eshte pergjegjes per pergatitjen dhe paraqitjen e pershtatshme e te sinqerte te ketyre Pasqyrave Financiare ne perputhje me Standartet Kombetare te Kontabilitetit.

Kjo pergjegjesi perfshin;hartimin, venien ne zbatim dhe mbajtjen e kontrollit te brendshem te pershtatshem per pergatitjen dhe paraqitjen e sinqerte te ketyre pasqyrave financiare pa anomali materiale te shkaktuara nga mashtrimi ose gabimi; zgjedhjen dhe zbatimin e metodave te pershtatshme kontabel, si dhe kryerjen e çmuarjeve kontabel qe jane te aresyeshme per rrethanat e dhena.

Pergjegjesia e shoqerise tone audituese eshte qe te shprehim nje opinion per keto pasqyra financiare bazuar ne auditimin e kryer. Auditimi i kryer nga ana e jone u be ne perputhje me Standartet Nderkombetare te Auditimit. Keto standarte kerkojne qe ne te zbatojme kerkesat e etikës dhe te planifikojme e te kryejme auditimin me qellimin, per te marre siguri te arsyeshme nese Pasqyrat Financiare jane pa anomali materiale.

Auditimi perfshiu;kryerjen e procedurave per te mare evidence auditimi rreth shumave dhe informacioneve te dhena ne pasqyrat financiare.Procedurat e zgjedhura varen prej gjykimit te audituesit, duke perfshire vleresimin e rrezeqeve per anomali materiale ne pasqyrat financiare, qofte per shkak te mashtrimit ose te gabimit.

Ne berjen e ketyre vleresimeve te rrezikut, audituesi merr ne konsiderate kontrollin e brendshem perkates te entitetit ne pergatitjen dhe paraqitjen me sinqeritet te pasqyrave financiare ne menyre qe te hartoje procedurat e auditimit qe jane te pershtatshme per rrethanat perkatese te entitetit, por jo per qellimin e shprehjes se opinionit per efektivitetin e kontrollit te brendshem te entitetit.

Auditimi gjithashtu perfshin vleresimin e pershtatshmerise se metodave kontabel te perdorura dhe llogjiken e çmuarjeve kontabel te bere nga drejtimi me vecorite specifike te saj, si dhe per vleresimin e paraqitjes se pergjithshme te pasqyrave financiare.

Ne besojme se evidenca e auditimit qe kemi marre eshte e mjaftueshme dhe e pershtatshme per te dhene bazat e opinionit tone te auditimit.

Sipas opinionit tone, Pasqyrat Financiare te Komitetit Olimpik Kombetar Shqiptar japin **nje pamje te vertete dhe te sinqerte** te gjendjes financiare per periudhen ushtrimore Janar - Dhjetor 2011, dhe performancen e saj financiare ne perputhje me Standartet Kombetare te Kontabilitetit.

**Audituesi**

**"LIRENG Auditing" Sh.p.k**

**Neshat MAZE (Ekspert Kontabel i Regjistruar)**

Tirane, Maj 2012

